



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:063621

Datë: 21.10.2024

Numri i dokumentit: 06329674

KF.nr.687/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtaren Vera Gashi Bala, në kontestin tregtar administrativ, të paditësit NTP “Graniti Petrol”, me numër unik identifikues 810686107, dhe me seli në Vushtrri, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Armend Deskaj, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulim vendimi, objekt kontesti ndëshkim tatimor, vlerë kontesti 600.00 €, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur me datë 11.10.2024 në prani përfaqësuesit të paditësit Armend Deskaj Avokat dhe në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës, gjykata, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar, kërkesëpadia e paditësit NTP “Graniti Petrol”, me numër unik identifikues 810686107, dhe me seli në Vushtrri.
- II. ANULOHET vendimi i të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, nr. 586/21, i datës 29.12.2021.
- III. OBLIGOHET e paditura Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, që paditësit NTP “Graniti Petrol” me seli në Vushtrri, t’ia kthej mjetet e paguara në emër të ndëshkimit tatimor në shumë prej 600.00 euro, (gjashtëqind euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi.
- IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës

A r s y e t i m

Paditësi, me padinë e paraqitur në gjykatë, ka kundërshtuar vendimin e të paditurit, Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në Prishtinë, me numër 586/2021, datë 29.12.2021, duke kërkuar

që kërkesëpadia e tij të aprovohet, vendimi i të paditurës me numër 586/21 të anulohet si i pabazuar dhe e paditura të detyrohet të paguajë shpenzimet e procedurës nën kërcënimin e përmbarrimit. Gjatë seancës kryesore gjyqësore, paditësi e precizoi kërkesëpadinë, duke kërkuar që vendimi me numër 586/21 të anulohet dhe e paditura të detyrohet të kthejë shumën prej 600 eurosh, të cilën ai e kishte paguar si rezultat i këtij vendimi. Lidhur me këtë vendim, paditësi e informoi gjykatën se ai është bazuar në raportin e inspektorit S.H., të cilin e ka kundërshtuar, me arsyetimin se inspektori gjatë ushtrimit të detyrës së tij ka vepruar në kundërshtim me Ligjin për Administratën Tatimore të Kosovës dhe Udhëzimin Administrativ 15/2010, konkretisht nenin 27, paragrafi 10. Paditësi deklaroi se inspektori ka vepruar në mënyrë jo profesionale ndaj tatimpaguesit, të cilët kanë informuar të paditurën për sjelljet e tij dhe kanë kërkuar zëvendësimin e tij me një inspektor tjetër. Gjykatës i ka propozuar që me qëllim të respektimit të parimit të efikasitetit procedural, të pranojë si dëshmi procesverbalet e çështjes KF.nr.199/22, në të cilat janë dëgjuar dëshmitarët R.Sh. si pronar i T/P-së, inspektori S.H., inspektori F.S. dhe dëshmitari B.H.. Gjithashtu, dorëzon aktgjykimin për çështjen KF.nr.199/22, me të cilin kërkesëpadia e paditësit është aprovuar si e bazuar dhe e paditura ATK është obliguar t'i kthejë paditësit shumën prej 1,200 euro. Së fundi, paditësi i propozon gjykatës që, në përputhje me nenet 43, paragrafi 3, dhe 46, paragrafi 3, të LKA-së, të nxjerrë një aktgjykim merititor, me të cilin do të aprovohet kërkesëpadia e paditësit si e bazuar.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 19.04.2022, i kundërshton në tërësi pretendimet e paditësit të paraqitur si të pabazuara në ligj dhe faktet materiale, dhe vlerëson se vendimi i DA të ATK-së nr.98/22 është i drejtë dhe i bazuar në legjislacionin tatimor të aplikueshëm në Republikën e Kosovës. Ka theksuar se ATK, ndaj paditësit në procedurë ka kryer vizitë tatimore, bazuar në Ligjin nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, e cila kontroll ka rezultuar me gjobë për shkak se paditësi nuk ka ofruar dokumentacion e kërkuar nga ana e Inspektorit sipas detyrës zyrtare dhe nuk ka bashkëpunuar fare me Inspektorin e ATK-së, duke mos ofruar qasje në libra dhe regjistrime, prandaj ATK-ja vërteton se ZGJONA me të drejtë ka aplikuar ndëshkimet bazuar në nenin 15, paragrafi 3, të Ligjit nr.03/L-222. Tutja ka shtuar se paditësi duke mos u përgjigjur kërkesave ligjore të Inspektorit dhe duke mos siguruar qasje në libra dhe regjistrime ka vepruar në kundërshtim të nenit 15 dhe 15 të Ligjit nr.03/L-222, prandaj dhe i kanë shqiptuar gjobat bazuar në dispozita ligjore dhe pretendimet e palës së paditur në padi janë të pa bazuar për gjitha gjobat janë në harmoni me legjislacionin tatimor.

Gjykata ka shqyrtuar këtë kontest tregtar - administrativ konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, në mungesë të palës së paditur ngase e paditur e ka pranuar ftesën për këtë seancë, ndërsa me parashtesën e datës 11.10.2024 e ka njoftuar gjykatën se nuk do të prezantoj në këtë seancë duke kërkuar nga gjykata që të veproj në pajtim me nenin 38 par 5 të LKA-së. Gjithashtu Gjykatës i ka propozuar që ta lë në fuqi Vendimin e Departamentit të Ankesave të ATK.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit gjyqësor kryesor publik të datës: Vendimi kontestues nr.586/2021 i datës 29.12.2021, foto dokumentacioni, Dokumenti AU003, Vendim i ZGJONA nr.768/2021, 794/2021, 795/2021, 796/2021, 797/2021, 798/2021 i datës 21.10.2021, Përgjigje në padi e datës 19.04.2022, Forma për vizita përmbushëse e datës 01.10.2021, 04.10.2021, 05.10.2021, 06.10.2021, 07.10.2021, 08.10.2021, Gjendja e borxheve e datës 19.04.2022 dhe 22.04.2022, Aktgjykimi KF.nr.199/22, Procesverbal i lëndës KF.nr.199/22 i datës 26.05.2023, Gjendja e borxheve datës 27.05.2022, Aktgjykim K.DH.SH.II.nr 932/23 i datës 19.01.2024, marrëveshja për pagesën e borxheve.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thënieve në padi, përgjigjes në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë konflikt administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga provat e administruara në këtë kontest tregtar administrativ, nga deklaratimet në padi, shkresat e lëndës, vendimi kontestues, dhe deklarimeve në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor, Gjykata ka gjetur se nuk është kontestuese se tatimpaguesit me datë 18.10.2020 i është hapur procedura e kontrollit, ku me datë 21.12.2020 tatimpaguesit i është dorëzuar njoftimi për hapjen e procedurës së kontrollit. Po ashtu nuk është kontestuese as fakti se paditësi ka pranuar vendimin mbi shqiptimin e ndëshkimit administrativ nr.768/2021, 794/2021, 795/2021,796/2021, 797/2021 dhe 798/2021 në vlerë prej 600.00 (pesëqind) euro, e ndaj të cilave ka ushtruar ankesë në ATK, e për të cilin ankesë këtu e paditura me datë 29.12.2021 ka nxjerr vendimin nr.586/2021, si akt administrativ përfundimtar i nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë, me të cilin ka refuzuar kërkesën e subjektin në procedurë, e kundër të cilit paditësi me padi ka iniciuar këtë kontest tregtar administrativ.

Gjykata ka gjetur se e paditura në arsyetim të aktvendimit kontestues nr.586/21 të datës 29.12.2021, ka theksuar se tatimpaguesi këtu paditësi të mbetet obligues i ndëshkimit sipas 768/2021, 794/2021, 795/2021, 796/2021, 797/2021, 798/2021 të datës 21.10.2021 në vlerë prej 600.00 euro, lëshuar në përputhshmëri të nenit 15 të paragrafit 3 dhe nenit 53 paragrafi 5 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Po ashtu ka theksuar se tatimpaguesi edhe pse i dakorduar me inspektorin se intervista fillestare të zhvillohet me datë 03.06.2021, ku në të njëjtin datë tatimpaguesi është vizituar nga ana e ATK-së i njëjti nuk i është përgjigjur afateve dhe nuk ka bashkëpunuar pasi që në ditën kur është caktuar intervista fillestare i njëjti ishte duke udhëtuar për në Zvicër. Po ashtu është kërkuar nga personi i autorizuar që të siguroj kopjet e listave të stoqeve që nga viti 2014 deri në vitin 2019 si dhe kopjet e librave të blerjes dhe shitjes për vitet 2015 dhe 2016, mirëpo personi i autorizuar nuk i ka dorëzuar këto dokumente duke deklaruar se kur të vjen pronari do ti sigurojmë gjë e cila nuk ndodhi. Po ashtu tatimpaguesi vazhdon të mos bashkëpunoj me Administratën Tatimore të Kosovës duke mos ofruar qasje në libra dhe regjistrime, andaj vërtetohet se Zgjeta me të drejtë ka aplikuar ndëshkimet bazuar në nenin 15, paragrafi 3, të Ligjit nr.03/L-222, i cili parasheh *“Çdo person i cili nuk paraqitet në kohë dhe vendin e specifikuar, apo për të dhënë informatat, në përgjigje të kërkesave për informata të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, do t'i nënshtrohen gjobë 500.00 (pesëqindën) euro”,* ndërsa sipas paragrafit 1, të këtij neni parashihet mbledhja e informatave siç vijon *“Duke iu nënshtruar paragrafit 4 të këtij neni, Drejtori i Përgjithshëm, me anë të njoftimit me shkrim, mund të kërkoj qoftë nga një person i detyruar të paguaj tatim apo nga një person që nuk ka detyrim të tillë, të 1.1 përgatisë dokumente të caktuara të kërkuara me njoftim brenda shtatë ditëve pas dorëzimit të njoftimit, apo periudhë kohore të tillë gjatë së mund të pajtohet në mes të ATK-së dhe personit nga i cili janë kërkuar dokumente...”*

Gjykata ka konstatuar se e paditura, në arsyetimin e aktvendimit kontestues nr. 586/2021, ka pohuar se gjoba prej 600 euro është vendosur në përputhje me nenin 53, paragrafi 5, i cili përcakton: *“Çdo person që ka për detyrë të sigurojë qasje në librat dhe regjistrimet ose që ndryshe nuk përmbush detyrimet e parashikuara nga nenet 14 dhe 15 të Ligjit, do t'i nënshtrohet një gjobe prej njëqind (100) euro për çdo ditë vonese pas skadimit të afatit të caktuar nga ATK. Në këto raste, ATK mund gjithashtu të kërkojë autorizim gjyqësor për të lejuar hyrjen ose qasjen e parashikuar sipas neneve 14 dhe 15 të këtij ligji.”* Prandaj, në këtë rast, paditësi ka vepruar në kundërshtim me nenet 14 dhe 15 të Ligjit nr. 03/L-222.

Në arsyetimin e saj, e paditura ka pohuar se, edhe pse tatimpaguesi ishte dakorduar me inspektorin që intervista fillestare të mbahej më 03.06.2021, ATK-ja e ka vizituar atë, por tatimpaguesi nuk i është përgjigjur afateve dhe nuk ka bashkëpunuar, pasi në datën e intervistës së planifikuar, ishte nisur për në Zvicër. Gjithashtu, është kërkuar nga përfaqësuesi i autorizuar i paditësit që të sigurojë kopjet e listave të stoqeve nga viti 2014 deri në vitin 2019, si dhe kopjet e librave të blerjes dhe shitjes për vitet 2015 dhe 2016, por përfaqësuesi ka deklaruar se dokumentet do të dorëzohen kur të kthehet pronari, çka nuk ka ndodhur.

Gjykata vlerëson se ky konstatim nuk qëndron, kjo për faktin se, tatimpaguesit i është ofruar një zyrë për të zhvilluar kontrollin tatimor, dhe në atë zyrë paditësi posedonte të gjithë dokumentacionin e biznesit, fakt që është konfirmuar nga leximi i procesverbalit KF.nr.199/22 ku ishin dëgjuar në cilësinë e palës vetë paditësi, dëshmitari B.H., si dhe inspektori S.H., i cili deklaroi se: "*Kemi filluar kontrollin tek tatimpaguesi, por vlerësuam se në zyrën e tij nuk kishte kushte elementare për zhvillimin e kontrollit.*" Për këtë arsye, është vendosur që kontrolli të kryhet në zyrën ose objektin e ATK-së. Nga këto deklarata mund të konstatohet se paditësi ka ofruar qasje në dokumentacionin kontabël në zyrën e tij gjatë vizitës së ATK-së. Megjithatë, inspektori S.H. ka vlerësuar se kushtet në zyrën e tatimpaguesit nuk ishin të përshtatshme për zhvillimin e kontrollit, dhe për këtë arsye, është vendosur që kontrolli të zhvillohej në ambientet e ATK-së.

Gjykata, nga leximi i procesverbalit KF.nr.199/22, ku është dëgjuar paditësi R.Sh. në cilësinë e palës, ka konstatuar se ai më datë 21.12.2020, ka pranuar njoftimin për kryerjen e kontrollit nga e paditura. Më tej, më datë 11.01.2021, së bashku me inspektorin e ATK-së, S.H. dhe një koleg të tij, kanë kryer matjen e stokut dhe, po atë ditë, janë prezantuar dokumentet dhe hapësira e punës për realizimin e kontrollit nga ATK-ja. Gjatë vizitës së inspektorit S.H. më datë 27.05.2021 në ambientet e punës së tatimpaguesit (paditësit), inspektori ka vlerësuar se hapësira e ofruar nga paditësi nuk kishte kushte të përshtatshme pune dhe ka vendosur që kontrolli të kryhej në zyrën ose objektin e ATK-së. Megjithatë, pavarësisht këtij vendimi, inspektori tatimor nuk ka marrë dokumentacionin relevant kontabël që i ishte vënë në dispozicion për të vazhduar kontrollin në ambientin e përcaktuar prej tij.

Më tej, Gjykata, nga leximi i procesverbalit KF.nr.199/22, ku është dëgjuar dëshmitari B.H., në cilësinë e personit të autorizuar nga paditësi, ka konstatuar se B.H. i ka treguar inspektorëve të ATK-së vendndodhjen e zyrës ku ata mund të kryejnë kontrollin dhe u ka prezantuar dokumentacionin përkatës në zyrën e tatimpaguesit, këtu paditësit.

Gjithashtu, nga leximi i procesverbalit KF.nr.199/22 ku ishte dëgjuar dëshmitari S.H. Inspektor Tatimor pranë të paditurës, vërtetohet se paditësi ka caktuar personin e autorizuar B.H. për kontrollin e filluar nga ATK për periudhën në fjalë, dhe kontrolli ka nisur tek tatimpaguesi (paditësi), ku më datë 11.01.2021 është kryer edhe verifikimi i stokut. Inspektori tatimor S.H. ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me paditësin që nga fillimi i kontrollit, por vetëm me parashtrësën e datës 03.06.2021 e ka njoftuar paditësin për pamundësinë e realizimit të kontrollit në zyrën e tatimpaguesit, duke përcaktuar si vend kontrolli zyrat e ATK-së. Megjithëse kishte qasje të plotë në dokumentacionin kontabël, inspektori nuk e mori këtë dokumentacion kur vendosi të ndryshojë vendin e kontrollit. Gjithashtu, nga dëgjimi i dëshmitarit F.S., Inspektor Tatimor pranë të paditurës, është vërtetuar se ky inspektor ka filluar dhe realizuar kontrollin në selinë e tatimpaguesit (paditësit), ku tatimpaguesi ka pasur gjithë dokumentacionin dhe ka siguruar qasje të plotë në të, për periudhën nga 01/2016 deri më 31.09.2020.

Nga të lartcekurat, Gjykata konstaton se paditësi ka lejuar qasje në zyrën përkatëse në selinë e tatimpaguesit dhe në dokumentacionin që ishte prezent në këtë zyrë. Ky fakt konfirmohet edhe nga e paditura, e cila në deklaratimet e saja gjatë shqyrtimit gjyqësor të lëndës KF.nr.199/22 ka theksuar se pas ndërrimit të inspektorit tatimor S.H. dhe pas autorizimit të inspektorit tjetër tatimor F.S. për realizimin e këtij kontrolli, ka pranuar se ky i fundit e ka filluar kontrollin tek tatimpaguesi, paditësi, më datë 03.03.2022, për të njëjtën periudhë kontrolli për të cilën ishte autorizuar edhe inspektori paraprak. Në dëshminë e tij, inspektori tatimor F.S. deklaron: *“Në bazë të autorizimit të marrë nga drejtori, kontrollin e kam filluar në selinë e tatimpaguesit në Shipol të Mitrovicës, në një zyrë të vogël të tatimpaguesit, në një tavolinë, dhe kam vazhduar me procedurat. Tatimpaguesi kishte të gjithë dokumentacionin në këtë zyrë, dhe kam pasur qasje të plotë në të.”*

Gjykata vlerëson se format për vizita të inspektorit tatimor në të cilat është mbështetur vendimi i ZGjONA nuk është dashur të merren për bazë për aplikimin e ndëshkimeve, pasi në rastin konkret është vërtetuar në mënyrë të pakontestueshme se e paditura ka pasur qasje të plotë në zyrën e tatimpaguesit, respektivisht në dokumentacionin përkatës për realizimin e kontrollit. Për më tepër e njetjat nuk ka kërkuar të administroj pikënisjen e këtyre raportimeve e që ka qenë forma për vizita përmbushëse e datës 03.06.2021, nga e cila pastaj kanë rrjedh këtu 6 format tjerat të cilat i ka parashtruar inspektori tatimor si mos veprim të paditësit sipas vizitës së datës 03.06.2021.

Gjykata ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit 03/L-222, mbi të cilat është mbështetur e paditura për shqiptime ndëshkimesh, duke përfshirë Nenin 14, që rregullon qasjen në libra, regjistrime, kompjuterë dhe pajisje të tjera për ruajtjen e regjistrave, ku në paragrafin 1 përcakton se: “ . Duke iu nënshtruar kufizimeve të këtij Neni, Drejtori i Përgjithshëm ose ndonjë zyrtar i autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm me shkrim për këtë qëllim të veçantë, në çdo kohë dhe me njoftim paraprak, përveç nëse me mendimin e Drejtorit të Përgjithshëm rrethanat e përjashtueshme e kërkojnë ndryshe, do të ketë qasje të plotë dhe të lirë në çdo objekt ku kryhet biznes, apo aty ku gjenden libra, regjistrime, kompjuter ose pajisje të ngjashme për ruajtjen e regjistrave aty ku ka shkaqe të arsyeshme për të konkluduar se qasja mund t'i sigurojë Drejtorit të Përgjithshëm materiale përkatëse lidhur me çdo lloj detyrimi tatimor. Pavarësisht nga fjalia e mëparshme, Drejtori i Përgjithshëm, apo çdo zyrtar i autorizuar nga Drejtori i Përgjithshëm mund të bëjë vizita, nuk përfshihen kontrollet, për të konfirmuar përmbushjen me ligjet tatimore në fuqi, për të marrë informatat përkatëse për aktivitete të mëvonshme kontrolli dhe për të mbledhur borxhet tatimore obligative të kaluara që konsiderohen të nevojshme pa njoftim paraprak për tatimpaguesin. Mosdhënia e qasjes në përputhje me nenin 14. dhe 15. të këtij ligji do prek personin i cili refuzon qasjen sipas dispozitave të paragrafit 5. të nenit 53 të këtij ligji.”

Nga interpretimi i këtyre dispozitave, Gjykata ka konstatuar se aplikimi i nenit 53, par. 5, është i mundur vetëm kur e paditura nuk ka marrë qasje të plotë dhe të lirë në objektet ose dokumentacionin e biznesit. Në rastin konkret, këto kushte nuk janë përmbushur, pasi, siç u provua në këtë proces gjyqësor, paditësi i ka ofruar të paditurës qasje të plotë dhe pa pengesa në objektet e biznesit dhe dokumentacionin përkatës. Kësisoj, aplikimi i ndëshkimeve në këtë rast, përveç që nuk është mbështetur në prova konkrete, nuk ka asnjë mbështetje ligjore.

Nuk është kontestuese që, për periudhën për të cilën janë shqiptuar ndëshkimet, kontrolli ka vazhduar dhe është përfunduar nga inspektori i ri tatimor, z. F.S., për periudhën tatimore 01/2016 deri më 31.09.2020, pa vërejtje në lidhje me qasjen në dokumentacionin kontabël të tatimpaguesit dhe pa aplikim ndëshkimesh sipas nenit 53, par. 5 të Ligjit 03/L-222.

Bazuar në këtë gjendje faktike, Gjykata vlerëson se pretendimet e paditësit janë të bazuara dhe të drejta, dhe se dokumentacioni i prezantuar është i pakontestueshëm ligjërisht. Prandaj, Gjykata, duke vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 43, par. 3 dhe nenit 46, par. 3 të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, aprovoi kërkesëpadinë e paditësit dhe e obligon të paditurën të

kthejë paditësit shumën e paguar prej 600.00 euro, e dëshmuar sipas marrëveshjes për pagesën e borxheve tatimore të datës 13.06.2022.

Gjykata gjithashtu mori parasysh deklaratimet e të paditurës të dhëna në përgjigjen ndaj padisë, por gjeti se ato nuk ndikojnë në ndryshimin e vendimit për këtë çështje administrative. Kjo, pasi pretendimet e paditësit janë të bazuara dhe ndëshkimet e vendosura nga e paditura, përveç që bien në kundërshtim me gjendjen faktike dhe provat e prezantuara nga paditësi, të cilat janë administruar nga gjykata, nuk kanë asnjë mbështetje ligjore dhe nuk janë kundërshtuar me prova materiale nga e paditura.

Gjykata vendosi për shpenzimet e procedurës në përputhje me nenin 64 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA) nr. 03/L-202.

Nga të lartcekurat, Gjykata, në përputhje me nenin 43, paragrafet 1 dhe 3, si dhe nenin 46, paragrafët 1,2,3,4 dhe 5 të LKA-së, ka vendosur si në dispozitiv të këtij këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Fiskale

KF.nr.687/22, datë 11.10.2024

Gjyqtarja
Vera Gashi Bala

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.